

buletini info

Buletin informativ mujor
Dhjetor, 2021



Është ndarë nga jeta RAMIZ ZIZAKU



Mbahet Mbledhja e
Kryesisë së IRDK-së



Projektet e financuara
me fokus te komuniteti



Kombi “Politik”



Buletini informativ info

Numri i fundit i buletinit informativ IRDK info ishte dalë në mars të vitit 2014. Ky buletin ishte ofruar lexuesve për më shumë se një vit dhe përmbante informacione lidhur me aktivitetet e IRDK-së, opinione të ndryshme lidhur me aktualitetin e kohës, të dhëna historike lidhur me prejardhjen etnike të Egjiptianëve në Ballkan dhe informacione tjera.

Buletini informativ do të vazhdojë të dalë në formën elektronike një herë në muaj, duke filluar prej muajit dhjetor. Aktivitetet lidhur me komunitetin tonë, trajtimi i problemeve të ndryshme të shprehura përmes opinioneve dhe informacione tjera historike, kulturore e shkencore do të jetë përmbajtja e këtij buletini informativ. I ftoj të gjithë veprimtarët tanë në Kosovë, rajon e diasporë të cilët kanë dëshirë që të kontribuojnë me shkrime të tyre në funksion të komunitetit tonë që të dërgojnë shkrimet e tyre në mënyrë që buletini të jetë i pasur me të dhëna të dobishme dhe në funksion të avancimit të kulturës sonë politike.

Kur kanë kaluar më shumë se 20 vite që komuniteti ynë është aktiv në politikë, përmes partive politike, kultura jonë politike ka degraduar sa i përket konkurrencës apo luftës politike që zhvillohet brenda komunitetit. Për shkak të luftës së ashpër politike, gjatë dekadës së kaluar ka pasur rritje të militantizmit dhe degradim të programeve, vizionit politik dhe demokracisë së brendshme brenda partive.

Gjatë periudhës 2014-2019, partia fituese e komunitetit egjiptian ishte përqendruar në përvetësim sa më të madh të masës përmes fushatave. Çdo punë që është bërë në dobi të

komunitetit ata e paraqiten si fitore e madhe. Ata tentuan që me një fasadë të bindin masën se rruga në fund do të rezultonte me një revolucion për komunitetin.

Marketingu i tepruar politik për të treguar forcë politike jo reale karshi masës e ka krijuar një ambient të turbullte për të bërë politikë reale. Rrëshqitja e subjekteve tona politike në beteja militantiste e humb kuptimin e aktivizmit të mirëfillt politik dhe politikën e shndërron në funksion të udhëheqësit. Komuniteti ynë ka nevojë për politikë që synon barazinë. Kjo nënkupton që komuniteti duhet që përmes përfaqësuesve të zgjedhur t'i adresoj dhe zgjidh problemet kryesore të cilat janë pengesë e pa kalueshme drejt prosperitetit për të qenë të barabartë. Prandaj nevojitet konsensus politik për shtyllat kryesore të angazhimit politik në mënyrë që të hapet rruga e zhvillimit dhe prosperitetit me objektivin kryesor për barazi.

Mundësia e zhvillimit të një debati brenda komunitetit për çështje të rëndësishme, përfshirë edhe politik bërjen, do të jetë edhe një mësim i mirë edhe për liderët politik në mënyrë që të mbahen përgjegjës edhe para intelektualëve të cilët mbajnë anë politike apo janë të pavarur. Prandaj Buletini mujor INFO, përmes informacioneve, opinioneve, të dhënave shkencore, do të jetë mundësi e mirë që politik bërja të jetë brenda binareve.

Fazli Stollaj



RAMIZ ZIZAKU
1954 - 2021

IRDK përgjithmonë krenar me Ramiz Zizakun

Pas një sëmundje, me datën 04.12.2021, ka ndërruar jetë veprimtari i orëve të para, Ramiz Zizaku.

Ramiz Zizaku, një intelektual i njohur në Pejë e më gjerë, në vitet '90 kishte migruar në Gjermani. Gjatë këtyre viteve ishte aktiv në aktivitetet që zhvilloheshin në Gjermani nga mërgata e Kosovës në lidhje me gjendjen e rëndë të popullit të Kosovës. Menjëherë pas përfundimit të luftës, Ramiz Zizaku u angazhuar fuqishëm në mbrojtjen e komunitetit të tij.

Ramiz Zizaku u bashkua në kauzën politike të IRDK-së duke dhënë kontribut shumë të madh në organizimin politik të diasporës sonë në Gjermani dhe Zvicër. Angazhimi kryesor i Ramizit mbetet bashkimi i komunitetit tonë të ndarë në Egjiptian dhe Ashkali dhe në rikthimin e IRDK-së në Parlamentin e Kosovës. Në periudhën 5 vjeçare sa IRDK nuk ishte në Parlamentin e Kosovës, Ramiz Zizaku ishte burimi kryesor i motivimit të strukturave të IRDK-së për të qëndruar në skenë dhe për t'u rikthyer në përfaqësimin e komunitetit.

Përpjekjet e pa rreshtura të Ramiz Zizakut për t'u rikthyer në Parlament u arritën në vitin 2019. Kauza e Ramiz Zizakut për bashkim të komunitetit duhet të realizohet nga IRDK dhe të gjitha partitë tjera të komunitetit tonë të ndarë.

IRDK përgjithmonë krenar me kontributin e Ramiz Zizakut për punën e tij të palodhshme, për motivimin e tij të vazhdueshëm dhe për kauzën e tij për komunitetin tonë.



RAMIZ ZIZAKUT I'U DHA LAMTUMIRA E FUNDIT

Me datën 8 Dhjetor 2021, në vendlindjen e tij në Pejë ka arritur nga Gjermania trupi i pajetë i Ramiz Zizakut.

Në praninë e familjareve, bashkëpartiakëve, miqëve dhe shokëve, në një mbledhje komemorative të organizuar nga IRDK, është përkujtuar jeta dhe veprat e Ramiz Zizakut.

Ministri i MAPL-së, z.Elbert Krasniqi, ka revokuar kujtime nga e kaluara e përbashkët me Ramizin dhe ka dhënë vlerësimet e tij nga këndvështrimi i bashkëpartiakut të Ramizit. Ai kishte burrëri, në rend të parë dhe i përkushtuar për komunitetin e tij sepse ai e donte popullin e tij, ka theksuar ministri Krasniqi.

Në këtë takim lamtumirës ka folur edhe deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës, z.Fridon Lala, z.Xhevdet Neziraj, z.Fazli Stollaj dhe familjarët e Ramiz Zizakut.

Në fund është shfaqur një video e punuar nga familja e Ramizit që përmbante fotografi e video nga momente të periudhave të ndryshme të jetës së Ramiz Zizakut.

Në librin e përkujtimeve kanë shkruar bashkëpartiakët e Ramizit: Elbert Krasniq, Fridon Lala, Xhevdet Neziraj, Fazli Stollaj, Muharrem Asllani, Hysnije Berisha, Avdyl Berisha, Aarjeta Shala, Fatlinda Radi.

Ramiz Zizaku është varrosur në ora 15:00, në prani të shumë miqëve e familjarëve, në varrezat e qytetit të tij të lindjes në Pejë.





Mbahet Mbledhja e Kryesisë së IRDK-së

Në mbledhjen e Kryesisë së IRDK-së, mbajtur me 25.12.2021, e kryesuar nga kryetari i IRDK-së Elbert Krasniqi, është bërë një përmbledhje e punëve të vitit 2021, janë përcaktuar objektivat për vitin 2022 dhe është diskutuar lidhur me Strategjinë e komuniteteve Romë dhe Ashkali.

Kryetari i IRDK-së, fillimisht ka përkujtuar dhe ka shprehur konsiderata të larta për anëtarin shumëvjeçar të IRDK-së Ramiz Zizakun për të cilin tha se ishte shtylla kryesore e IRDK-së në vitet më të vështira të IRDK-së dhe se do të na mungon shumë. Ai ka raportuar lidhur me punët e ministrisë të cilat kanë qenë me fokus te komuniteti Egjiptian. Ai ka numëruar projektet e realizuara nga MAPL nëpër komuna të ndryshme që në të ardhmen pritet të përmirësojnë jetën e komunitetit. Krahas detyrave tona në Ministri dhe Qeveri, fokusi ynë mbetet komuniteti. Ai përmendi edhe projektet e miratuara në buxhetin e Kosovës, bursat për mësimdhënësit e ardhshëm të komunitetit, mundësitë e mira për rritjen e numrit të pjesëtarëve të komunitetit në polici e FSK.

Deputeti Fridon Lala ka përmendur punët e realizuara për këtë periudhë nëntë mujore në Parlamentin e Kosovës. Ai ka përmendur përfshirjen e projekteve kapitale në buxhetin e Kosovës të cilat do të realizohen vitin e ardhshëm, asistencën e ofruar për përfituesit e masave të Qeverisë së Kosovës, Inicimin për amandamentim të Ligjit për festa zyrtare dhe punë tjera të realizuara gjatë këtyre muajve.

Për punët e realizuara në Ministrinë e Drejtësisë, Shëndetësisë, MAPL-së kanë raportuar këshilltarët e angazhuar në këto ministri.

Lidhur me objektivat për vitin e ardhshëm është vendosur që të fillohet me punë më të madhe në strukturimin e partisë, koordinimin më të mirë me të angazhuarve në institucione, angazhimin e stafit mbështetës në zyrën e IRDK-së dhe adresimin e vazhdueshëm të problemeve të komunitetit.

Në lidhje me Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve Romë dhe Ashkalinjë, Kryesia e IRDK-së ka vendosur që komuniteti Egjiptian nuk duhet të jetë pjesë e kësaj strategjie për shkak se kjo strategji për sa vite nuk ka evidentuar ndonjë rezultat për komunitetin Egjiptian. IRDK konsideron se problemet e komunitetit të cilat janë të shumta duhet të kenë trajtim sektorial.

Në Mbledhje të Kryesisë kanë qenë të kyçur online Selim Golla dhe Jeton Rrahmani të cilët kanë dhënë kontribut me diskutime në këtë mbledhje.

Lista e projekteve të financuara nga MAPL me fokus komunitetin Egjiptian / Ashkali gjatë vitit 2021



LIPJAN

-
- | | | |
|-------------------------------------|--|----------|
| ☒ | Rregullimi i kanalizimit në lagjen e komunitetit dhe asfaltimi i rrugicave në fshatin Gadime | 40 000 € |
|-------------------------------------|--|----------|



RAHOVEC

-
- | | | |
|-------------------------------------|---|----------|
| ☒ | Ndërtimi i rrugëve në lagjën e komuniteteve | 40 000 € |
|-------------------------------------|---|----------|



KLINË

-
- | | | |
|-------------------------------------|---|----------|
| ☒ | Asfaltimi i rrugëve Videjë-Jagodë-Budisalc-Berkovë dhe në Klinafç | 50 000 € |
|-------------------------------------|---|----------|



PODUJEVË

-
- | | | |
|-------------------------------------|---|----------|
| ☒ | Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse në lagjen e komuniteteve | 70 000 € |
|-------------------------------------|---|----------|



MITROVICË

-
- | | | |
|-------------------------------------|--|----------|
| ☒ | Ndërtimi i rrugëve në lagjen 2 Korriku | 40 000 € |
|-------------------------------------|--|----------|



FUSHË KOSOVË

-
- | | | |
|-------------------------------------|---------------------------------|----------|
| ☒ | Rikonstruktimi i rrugës Meshari | 50 000 € |
|-------------------------------------|---------------------------------|----------|

Lista e projekteve të financuara nga MAPL me fokus komunitetin Egjiptian / Ashkali gjatë vitit 2021



GJAKOVË

- | | | |
|-------------------------------------|---|----------|
| ☐ | Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni për lagjet e komuniteteve | 50 000 € |
| ☒ | Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike në rr."Lekë Dukagjini" - Dardani | 80 000 € |



PEJË

- | | | |
|-------------------------------------|--|----------|
| ☒ | Asfaltimi i rrugëve të minoriteteve në qytetin e Pejës dhe fshatra | 50 000 € |
|-------------------------------------|--|----------|



ISTOG

- | | | |
|-------------------------------------|--|----------|
| ☒ | Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe ndriçimi publik në lagjen Arif Ademi në Banjë dhe asfaltimi i rrugëve në komunën e Istogut (Rr.Livadhet e Thata, Lagja Jahaj, Lagja Llabjani) | 50 000 € |
| ☒ | Asfaltimi i rrugëve në komunën e Istogut (është përfshirë edhe Rr.Alush Aga) | 80 000 € |
| ☒ | Asfaltimi i rrugës Perëndimi në Gurrakoc | 31 000 € |

Komuna: Obiliq

Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit në Plemetin

Financimi nga MAPL: 74 298 €



Komuna: Fushë Kosovë

Rikonstruktimi i rrugës Meshari

Financimi nga MAPL: 40 000 €



Komuna: Istog

Asfaltimi i rrugës Perëndimi në Gurrakoc

Financimi nga MAPL: 31 000 €



Komuna: Klinë

Asfaltimi i rrugëve Videjë-Jagodë-Budisalc-Berkovë dhe në Klinafç

Financimi nga MAPL: 50 000 €





Kombi “Politik”

Fjala Komb rrjedh nga gjuha latine “natio” që do të thotë të lindësh, kombi ndahet në kombin e kulturës dhe kombi i shtetit. Kombi i kulturës nënkupton grup njerëzish me karakteristika të përbashkëta siç janë gjuha, kultura, tradita ndërsa kombi i shtetit nënkupton grup njerëzish që bashkohen brenda një shteti të caktuar dhe i nënshtrohen së bashku ligjit dhe rendit juridik kushtetues. Ashkalitë dhe Egjiptianët a janë komb i kulturës apo komb i shtetit?

Duke pasur parasysh karakteristikat e përbashkëta të këtyre dy komuniteteve në gjuhë, kulturë e traditë vijmë në përfundim që janë një komb pra komb i kulturës. Gjithashtu Ashkalitë dhe Egjiptianët të cilët jetojnë me shekuj në Ballkan e atdhe të tyre kanë Kosovën së bashku me shqiptarët, turqit, romët, boshnjakët etj krijojnë kombin e shtetit, kombin Kosovar për krijimin e së cilit kanë dhënë kontribut të pashembullt. Por pse sot në aspektin normativ janë të njohura si dy kategori të ndryshme kushtetuese? Për arsye të ndarjeve regjionale dhe dallimeve politike. Interesat e caktuara personale në politikë na kanë shndërruar në komb të politikës. Pluralizmi politik brenda kombit tonë pësoi progres të hovshëm duke krijuar kështu ideologji ksenofobe ndaj njëra tjetrës. Lufta për bajraktarizëm thelloi edhe më shumë përçarjet pasi që ajo ishte çfarë e hante pazari. Nëse ishte lider politik i cili i prijte valleve me flamurin me shqiponjën me një kokë ose shtroje një darkë ku mbizotëronte mishi rakia e tallavaja, me lehtësi siguroje votat e mjaftueshme për të zënë një ulëse të garantuar në Kuvendin e Kosovës. Pra me veprime të këtilla vërehet qartë që nuk ka pasur vullnet politik për bashkim

kombëtar, ndërsa populli dele duke ladruar pas liderëve kanë pranuar që të bëhemi komb politik. Pas plebishitit të 14 Shkurtit e tërë narrativa 22 vjeçare ka pësuar revolucion. Me 14 Shkurt as gajdja me flamur e as darka me mish, raki, def e sharki nuk kryenin më punë ngase kombi jonë donte liderë me elokuencë e seriozitet që ngrisin në pedestal komunitetin e tyre me aktivizmin e tyre. Vetëm nga mesi i vitit 2021 e tutje dolën në pah kuadrot tona, dolën në pah profesorët, inxhinierët, juristët e mantilbardhët që ndryshuan pasqyrën e cila shihej në syrin e të tjerëve si popull i pashkolluar e analfabet. Sot këta profesionist nxorrën në shesh pasqyrën reale, që përkundër vështirësive socio-ekonomike prapë kemi mjaftueshëm kuadro por atyre vetëm është dashur tu ipet mundësia. Sot mburremi të gjithë me profesionistët tanë të cilët ushtrojnë poste politike në dikastere të ndryshme. Kjo do të duhej të gëzonte edhe opozitën e tanishme të cilët duhet të marrin mësimin e duhur dhe të reformohen ose përndryshe i ekspozohen rrezikut së shuarjes së tërësishme ngase pothuajse për çdo ditë po shohim dorëheqje të aktivistëve më të devotshëm të këtyre partive që kërkojnë reforma të brendshme. Së bashku ne mundemi të bashkohemi si komb i kulturës duke dalë njëherë e mirë nga ky tranzicion si komb politik. Me shuarjen e autokratëve shuhet edhe kombi politik dhe arrijmë tek demokracia reale ku parimet demokratike të proklamuar me akte juridike dhe politike zbatohen dhe materializohen nga organet dhe institucionet shtetërore.

Jeton Rrahmani



Dr Marcel Courthiade (1953 - 2021)

Profesor Marcel Courthiade dha kontribut të çmueshëm me shkrime shkencore dhe paraqitje të tij lidhur me Egjiptianët e Ballkanit. Profesor Courthiade vdiç me 4 Mars 2021 në Tiranë. Për të kujtuar profesor Courthiade po e botojmë shkresën e tij drejtuar Konferencës shkencore të mbajtur në Prishtinë në vitin 2003.

Gëzohem shumë që më në fund çështja e miqve tanë Egjiptian merret para sysh me dinjitetin që meriton çdo komb, kombësi apo minoritet, pavarësisht nga numri i tij apo nga historia, profili etno-kulturor, trashëgimia gjuhësore apo situata sociale. Po ju dërgoj disa materiale që kisha përgatitur kohën e fundit e që janë botuar në Paris. Jam i bindur se duhet ndarë çështja e identitetit nga çështja e solidaritetit. Po, patjetër duhet të punojmë si me miqtë egjiptian, po ashtu me të gjitha kombet, kombësitë e minoritetet e botës, me një qëllim të përbashkët, i cili përbënë të vërtetën historike e shkencore, përkrahjen për ata që janë në një pozitë të shtypur apo të mohuar, përpjekje të përbashkët për të ngritur një botë më njerëzore e me vëllazërore, me drejtësi e respekt mutual midis njerëzve e midis identiteteve. Nuk duhet të kemi ndasi në këtë drejtim, por nga ana tjetër duhet të pranojmë atë që na sjellë studimi historisë, i gjuhës, i traditave, i gojëdhënave etj.

Nuk duhet ngatërruar gjithashtu planin kolektiv e planin individual: në planin kolektiv janë disa të dhëna shkencore, historike, kulturore etj... që nuk mund të mohohen, por nga ana individuale është e qartë se identiteti nuk mund të prehet dot me thikë: të gjithë jemi produkti jo vetëm i një kombi apo kombësie nga kemi dalë, por edhe nga interakcionet, shkëmbimet e pasurimit mutual midis identiteteve në shoqëri.

Kur them identitet, nuk mendoj vetëm për identitetin etnik, por më gjerë: profesionale, politike, gjinore, regjionale etj. Prandaj njeriu ka identitet të shumë anshëm, që nuk mund të reduktohet në një karikaturë ose eksponat muzeal. Do të ishte gabim të besojmë se “në qoftë se jemi më shumë, jemi më të fortë”. Kjo është ligji i xhunglës. Më i miri propozim është: “në qoftë se jemi më me vetëdije, më me dije, më me qartësi intelektuale si dhe më të lidhur në shpirtin e solidaritetit, atëherë më të vërtetë do të jemi më të fortë”. Shpesh herë janë ngatërruar këto të dyja: nga një anë uniteti i identitetit (prejardhja, kultura etj...), dhe uniteti i veprimit nga ana tjetër (politika, angazhimi, lobby etj...). në vend që të qojë në një kohezion më të fortë të identiteteve, ka quar në mohimin e shumicës prej tyre. Këtë politikë e kanë ndjekur shumë shtete në dëm të minoriteteve, për të ndërtuar një “komb –shtet” më të fortë, duke mohuar minoritetet, e si pasojë, duke emituar vetë “shtet-kombin” që po e ndërtonin. Fatkeqësisht këtë politikë e kanë ndjekur edhe mjaft lider Rom, duke mohuar identitetin Egjiptian, ose duke e kthyer në një rimorkio të identitetit rom për hir të numrit. Në këtë aspekt, kanë ndjekur e imituar politikën mohuese të “gaxhive”. Në Evropë tani ngritët nocioni i minoriteteve pa territor kompakt. Jemi afro dhjetë minoritete të tilla në kontinentin tonë dhe Romët, Egjiptianët, Vllenjët, Laponët, Euro-amazigjet e Beashtet, për të përmendur vetëm disa prej tyre, bëjnë pjesë në këtë numër. A duhet të themi se të gjithë janë romë? Në asnjë mënyrë. Atëherë pse të thuhet se vetëm Romët, Egjiptianët e dy tre grupe tjera janë Romë? Vetëm për të ndjekur etiketimin që kanë bërë para disa shekujsh disa katunar analfabet në Perandorinë Bizantine. Duket qartë se kjo nuk është një burim shkencor prandaj është më e drejtë nga ana shkencore, si dhe nga ana njerëzore, që ta konsiderojmë Evropën me këtë koncept të minoriteteve pa territor kompakt ku ne jemi një pjesë e saj. Disa që janë më guximtar thonë edhe “kombe e kombësi pa territor kompakt (ose me vendbanim të shpërndarë)” përbri kombeve e kombësive me territor kompakt, por kjo akoma nuk ka hyrë në fjalorin evropian. Lidhur më këtë po përgatisim një ekspozitë për Bashkinë e Parisit. Do të mbahet në maj 2004, në kuadër të festivalit “Montmartre en Europe” e shpresojmë që do të mbahet paralelisht një kuvend shkencor me paraqitjen e këtyre minoriteteve pa territor kompakt, të cilat shpesh herë janë harruar nga Evropa. Ne që jemi të njohur me planin evropian kemi për detyrë të ndihmojmë miqtë tanë të harruar në afirmimin e identitetit të tyre, jo ti mohojmë edhe ne apo t'i asimilojmë kundër të dhënave shkencore e kundër dëshirës së tyre. Jam shumë i kënaqur për mbajtjen e kësaj konference në Institutin e juaj. Po ju dëshiroj shumë sukses e të jepni një ndihmesë me rendësi për të vërtetën shkencore, e si pasojë, për paqen e stabilitetin në Ballkan e më gjerë, sepse paqja e stabiliteti ndërtohen më fortë në bazë të analizave të qarta sesa në bazë të spekulimeve me interes pamje shkurtër.

Dr Marcel Courthiade

Profesor në Universitetin e Parisit (INALCO)

Komisar i Bashkimit Ndërkombëtar të Romëve për gjuhën e të drejtat gjuhësore

Maysar Omar

Pjesë nga libri "Çështja e ngatërruar e Egjiptianëve të Ballkanit", e botuar në vitin 2015

HYRJE PËR BALLKANIN DHE EGJIPTIANËT E TIJ

Ballkani, ose "Gadishulli Ballkanik", është rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës juglindore. Këtu përfshihen shtete aktuale: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, dhe Kosova që ende nuk është pranuar si shtet sovran nga disa shtete (përfshirë Kinën dhe Rusinë), megjithatë është pranuar nga SHBA dhe shumica e shteteve Evropiane. Për shkak të ngjarjeve të ndryshme historike, disa shtete tjera të cilat nuk identifikohen në veçanti si Ballkan, janë të lidhura ngushtë me historinë e Ballkanit, siç janë Moldavia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia. Nuk ka shkëputje të qarta apo linja të theksuara të ndarjes së kush është kush, kur është fjala për një perspektivë historike të Ballkanit. Ky është rajon i konfuzionit dhe mozaik kompleks i identiteteve, ndoshta për shkak se rajoni është i rrethuar nga tri dete të ndryshme nga tri drejtime të ndryshme.

Vendndodhja gjeografike e Ballkanit e kërkonte që të bëhet pikë takimi i aq shumë kulturave, nganjëherë edhe kontradiktore me njëra tjetrën. Kultura antike greke dhe gjuha rezistuan këtu ndoshta më shumë se kudo tjetër në botë, edhe pas dominimit të Perandorisë Romake në gjithë rajonin. Perandoritë Sllave, Bizantine, Bullgare dhe Serbe luftuan dhe u përplasën me njëra tjetrën dhe së bashku gjatë gjithë periudhës post klasike (dmth Mesjetës) e sunduan gadishullit. Prej shekullit të 16të Otomanët e sunduan rajonin dhe e përhapen islamin të banorët e gadishullit. Ata nuk u larguan nga rajoni deri në vitin 1913 kur aleanca Greko-Serbo-Bullgare i sulmoi ashpër Turqit. Luftërat Otomane kundër fuqive Evropiane në Ballkan duket të ketë qenë arsyeja kryesore e prapambetjes së rajonit, e cila vlerësohet të ketë pësuar një humbje drastike të jo më pak se dy të tretat e popullsisë së saj gjatë shekujve 17të dhe 18të. Por dëbimi i turqve ka çuar edhe në rritjen e nacionalizmit në Ballkan, pasojat e të cilave ishin nganjëherë të rënda dhe ndihen ende edhe sot.

Historia moderne e Ballkanit është komplekse dhe vazhdimisht e dhunshme, me Luftën e Parë Botërore duke parë përçarje të brendshme dhe luftëra, dhe Luftën e Dytë Botërore duke parë unitetin e të gjitha shteteve të Ballkanit prapa aleatëve të Boshtit (Italia, Gjermania, dhe Bullgaria) kundër Greqisë dhe Jugosllavisë të cilët përfundimisht u nënshtruan ndaj forcave të Boshtit. Në fund të luftës, Gjermania ia la Rusëve Rumaninë dhe Bullgarinë, dhe pjesa tjetër e Ballkanit mbeti e varfër dhe e uritur, dhe të paktën me 1 milion të vdekur. Bashkimi Sovjetik e mori kontrollin në pjesën më të madhe të Ballkanit dhe e mbajti deri në rënien Sovjetike, atëherë kur mosha e gjatë e mozaikut të identitetit Ballkanik filloi të shpërthejë si problem serioz, që zgjat edhe sot. Shpërbërja e Jugosllavisë, rritja e nacionalizmit serb, formimi i shpejtë i identiteteve të reja kombëtare, dhe shumë faktorë të tjerë të panumërt, shkaktuan një fluks dhe konfuzion të madh të migrimit dhe konfrontimit etnik. Dhunë e madhe ndodhi kudo në Ballkan, me disa përjashtime, dhe vetëm në vitet e fundit rajoni filloi të qetësohet, por mbeti i ngarkuar me mosmarrëveshje të vazhdueshme dhe pakënaqësi të shkaktuara nga konceptet e ekzistencës së identitetit dhe grupit nacional.

Ky tregim i shkurtër ishte i rëndësishëm në mënyrë që të ofrohet një prapavijë në pikturën e mëdha, në të cilën subjekti i këtij punimi, Egjiptianët e Ballkanit dhe komunitetet tjera Gjipësi, u përfshinë për një kohe kaq të gjatë, dhe mund të kenë qëndruar dëshmitar për të gjitha detajet, por kryesisht pa u vërejtur, pa u shqetësuar shumë, sikurse shtegtar pelegrin!

Egjiptianët e Ballkanit jetojnë në disa shtete të Ballkanit, kryesisht në Kosovë, Shqipëri dhe në Republikën e Maqedonisë, por gjenden në numër më të vogël edhe në disa shtete tjera të Ballkanit.

Në secilin nga këto vende shqiptim i emrit të tyre "Egjiptian" ndryshon: në Shqipëri janë "Gjyp, Egjyp, Magjyp, Evgjitë, dhe Jevg", në Maqedoni "Gjupci, Egjupci, Jupci, Ejupci dhe Ojupci"; në Bullgari ata janë "Agupti"; Në Turqi "Kepti ose Kiptijani, dhe Misirli"; ata gjithashtu ndonjëherë janë të njohur si "Faraon, Firaon, dhe Farvan" (Zemon 2003: 8). Gjuha e tyre amtare është kryesisht gjuha Shqipe dhe rrallë edhe gjuha Maqedone (Marushiakova dhe Popov, 2001: 471), dhe feja e tyre e deklaruar është Islami, e cila u adoptua gjatë sundimit Osman në Ballkan (Zemon 2003: 8). Në shoqëritë e secilit prej këtyre shteteve, ata janë konsideruar në përgjithësi të jetë emigrantë Gjipësi (ose Romë), si dhe emrat e përbashkëta të cilat këto shoqëri i caktojnë atyre shpesh janë me përcaktim nënçmues (të tilla si "Magjup" në Kosovë dhe Shqipëri). Kushtet e tyre sociale dhe ekonomike janë karakteristikë e shumë pakicave të tjera të marginalizuara, të mos respektuara dhe të shtypurve në mbarë botën, veçanërisht të pakicave Gjipësi. Muhamet Arifi, një udhëheqës i shquar i komunitetit Egjiptian në Ballkan, jep raportin e kushteve të tyre të tanishme, së bashku me një grup tjetër pakicë të quajtur "Ashkali":

"Komunitetet Egjiptianë dhe Ashkali ende përballen me probleme në arsim, punësim, shëndetësi, dokumentet e pronësisë, regjistrimit civil dhe shumë probleme të tjera. Për shkak të arsimit të ulët përqindja e papunësisë është ende rreth 98%. Nuk ka politika të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës apo bashkësia ndërkombëtare për të gjetur zgjidhje afatgjatë për punësim të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian ". (Arifi 2009: 3).

Situata është e keqe në atë masë sa që shumë Egjiptianë të Ballkanit përpiqen, dhe zakonisht me sukses emigrojnë ilegalisht në vendet perëndimore në kërkim të kushteve më të mira të jetës (Plaks 2008). Por "problemi më i madh", për të cituar Arifin, është se kur ata janë të detyruar të kthehen, ata kthehen për të jetuar në kampet e personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV):

"Ekzistojnë ende kampe të PZHBV-ve në Kosovë. Qeveria e Kosovës është duke punuar dhe duke u përpjekur për të mbyllur kampet e të zhvendosurve, por se është e vështirë për shkak se gjithnjë e më shumë njerëz janë duke u kthyer me forcë nga Evropa Perëndimore. Ata njerëz nuk kanë ku të jetojnë kështu që e vetmja zgjidhje është që të shkojnë dhe të jetojnë në kampet ekzistuese. Ashkalitë dhe Egjiptianët e kthyer me forcë kanë pasur probleme për të marrë dokumente personale, fëmijët e tyre nuk mund të shkojnë në shkollë për shkak se ata nuk flasin shqip, ata janë duke u përballur me shumë probleme shëndetësore dhe ekonomike etj. Askush nuk është duke i ndihmuar ata të kthyerit me forcë. Qeveria e Kosovës është duke u thënë atyre për të shkuar në UNHCR, dhe anasjelltas "(Arifi 2009: 3).

Një tjetër raport përmend si më poshtë:

"Minoritetet nuk ndihen të mbrojtur në mënyrë adekuate nga ana e autoriteteve të Kosovës [...] spastrimi etnik i organizuar sistematik u zhvillua në vitin 1999 dhe 2004, por gjatë gjithë kohës pasiguria e vazhdueshme ka qenë kronike. Ajo që është e rëndësishme është fakti se nuk është vetëm pasiguria aktuale por edhe perceptimi i minoriteteve nëse ata mund të jenë të mbrojtura në mënyrë adekuate " (Baldwin 2006: 16).

Këto raporte janë të mjaftueshme për pasur një përfytyrim të qartë të jetës së Egjiptianëve të Ballkanit, dhe na mundëson neve që nëse dëshirojmë mund të imagjinojmë të gjitha detajet tjera të papërmendura të varfërisë dhe prapambetjes të jetës së përditshme, marginalizimit social e ekonomik dhe diskriminimit në të cilin jetojnë.

Është më rendësi që të përmendim se Egjiptianët e Ballkanit nuk janë të vetëm nën këto kushte, sikurse janë edhe grupet tjera minoritare, siç janë Romët dhe Ashkalitë, ku të gjithë konsiderohen "Gjypës" nga shumica, të cilët vuajnë në shkallë të njëjtë, ose nganjëherë edhe më shumë (Zemon, 2005:25).

Egjiptianët e Ballkanit, përpos betejës ekonomike, duhet të luftojnë ende në një fushë të vështirë; kërkimet lidhur me grupimin rreth identitetit të tyre dhe mbrojtjen e tij: ata duhet që vazhdimisht të provojnë se nuk janë Gjypës, nuk janë Romë, nuk janë Shqiptarë, dhe nuk janë pa origjinë; dhe se ata janë djemtë dhe vajzat e Isait, ku me krenari brenda vetvetes bartin shpirtin, nëse jo edhe gjakun, e Egjiptianëve të cilët në fillimin e lashtë të historisë së kombeve bartin flakadanin e civilizimit botëror, kur ende ishte e pa perceptueshme zhytja në errësirën e primitivizmit.

buletini info

2022

January						
S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

February						
S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28					

March						
S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

April						
S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

May						
S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

June						
S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

July						
S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

August						
S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

September						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

October						
S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

November						
S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

December						
S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

2022 Holidays for Kosovo

Jan 1 New Year's Day
 Jan 7 Orthodox Christmas
 Feb 17 Independence Day
 Apr 9 Constitution Day

Apr 17 Easter Sunday
 Apr 24 Orthodox Easter
 May 1 Labour Day
 May 2 End of Ramadan (Eid al-Fitr)

May 9 Europe Day
 Jul 9 Feast of the Sacrifice (Eid al-Adha)
 Dec 25 Christmas Day